



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 23 të Ligjit të planifikimit hapsinor nr. 2003/14 dt.03.07.2003, nenit 3.1 shkronja **b** të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullorës 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, të nenit 16.1, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, të miratuar më 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës më 21.5.2008 merr

V E N D I M
MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR
LABORATORIN E METROLOGJISË NË PRISHTINE

Neni 1

Miratohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Laboratorin e metrologjisë në Prishtinë.

Neni 2

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Laboratorit të metrologjisë. Lokacioni nga paragrafi 1 i këtij Vendimi, përfshinë pjesët e ngastrave kadastrore nr. 2727/2 dhe nr. 2730/2, KK Prishtinë, të evidentuar, në fletën poseduese nr.9957, në lagjen "Kodra e Diellit", pronë shoqërore, në një sipërfaqe prej 15 ar.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për hartimin e projektit urbanistik të lokacionit nga paragrafi 2 i nenit 2 të këtij Vendimi, në bazë të të cilit do të caktohen kushtet urbanistike-teknike për lejimin e ndërtimit të objektit ndërtimor nga neni 1 i këtij Vendimi.

Projekti urbanistik, nga paragrafi 1 i këtij neni, do të punohet nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, sipas programit të prezantuar nga ana e investitorit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Financave Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Pronës, të Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nº 353-629, më 21.5.2008

KRYETAR I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa